

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ish-drejtuesi në SHISH: Vlora Hyseni ka pikëpyetje për të shkuarën, përgjegjës Rama dhe Begaj
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/23/ish-drejtuesi-ne-shish-vlora-hyseni-ka-pikepyetje-per-te-shkuaren-pergjegjes-rama-dhe-begaj/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 20:56:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 20:54:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c0a545fc95f06c6af068ef59a8a92b7908cee13a13a9a59a6dcfee3268d8adab
TEKSTI	d868c70b03fbe9449022ab5bc3909597c94486e5e8c2f897ba2474a362ecdb4a
PAMJA	9a8fb1c8c1b51fbd825731c73fda048c289edf4ccc6c37bc3581f74bea4463f6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e72a52aa184525095b1793d365f1561f618949f0cdec70417e4fa1d60a31a6c6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f13708d4cb43333cd442efe7c96fa8554969483459094e5d4825bc5f113135
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e72a52aa184525095b1793d365f1561f618949f0cdec70417e4fa1d60a31a6c6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Ish-drejtuesi në SHISH: Vlora Hyseni ka pikëpyetje për të shkuarën, përgjegjës Rama dhe Begaj

22:54 : 23/09/2026 në AKTUALITET, Lajmet e Dites



Ish-drejtuesi i Shërbimit Informativ Shtetëror, Evarist Beqiri, ka ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si Vlora Hyseni u përzgjedh për të drejtuar SHISH-in, duke e zhvendosur vëmendjen te procesi i emërimit dhe kontrolli institucional që paraprin vendosjen e një personi në krye të strukturës së sigurisë kombëtare.

I ftuar në emisionin "Now me Erla Mëhillin" në Euronews Albania, Beqiri tha se e njeh Hysenin prej periudhës kur ajo punonte në Kosovë dhe e cilësoi ngritjen e saj në detyrë si një rast ku, sipas tij, nuk është respektuar parimi i meritokracisë.

"Problemi është se ne duhet të merremi se si katapultohen këta individë në pozicione të tilla", u shpreh Beqiri, duke kërkuar që vëmendja të mos përqendrohet vetëm te personi që ka mbajtur detyrën, por edhe te mekanizmi përmes të cilit ajo është përzgjedhur.

Sipas tij, në SHISH ka punonjës me vite të tëra përvojë në fushën e inteligjencës dhe sigurisë, ndërsa emërimi i një drejtuesi nga jashtë këtij karrieri ngre pikëpyetje për mënyrën se si është vlerësuar profili profesional i kandidatit.

"A mundet që të promovohet duke shkelur me të dyja këmbët meritokracinë?", deklaroi ai.

Lexo edhe:

[Kur krimi mbërrin në majën e inteligjencës shqiptare](#)[Gazetarja: Ndërkombëtarët kërkuar ndërhyrjen e SPAK, aksesi i Agasit të SHISH ngriti pikëpyetje](#)

Një tjetër pikë e ngritur nga ish-drejtuesi i SHISH-it lidhet me verifikimin e së kaluarës së Hysenit përpara emërimit.

Beqiri tha se gjatë karrierës së saj në Kosovë kanë ekzistuar, sipas tij, pikëpyetje që duhet të ishin marrë në konsideratë nga institucionet shqiptare përpara se asaj t'i besohej drejtimi i SHISH-it.

TË GJITHA




Ish-drejtuesi në SHISH: Vlora Hyseni ka pikëpyetje për të shkuarën, përgjegjës Rama dhe Begaj

22:54 : 23/09/2026



49-vjeçari plagoset me thikë brenda një lokali, Policia: Arrestuam autorin (EMRAT)

22:38 : 23/09/2026



Publikohet telefonata e italianit pas vrasjes së shqiptarit: Unë thjesht u mbrojt

22:34 : 23/09/2026



SHBA qetëson NATO-n: Rusia nuk ka asnjë plan lufte kundër Aleancës

22:24 : 23/09/2026



'Jo në emrin tim', mijëra qytetarë sërish protestë në mbështetje të ish krerëve të UÇK-së

22:09 : 23/09/2026



Plagoset me thikë një person pranë shkollës "Petro Nini Luarasi" në Tiranë

22:00 : 23/09/2026



Përfundon marshimi nëpër Tiranë, qytetarët thirrje për tubim para Parlamentit: Nesër në orën 10:00!

22:00 : 23/09/2026

“Është bërë një kontroll kësaj të shkuarës së kësaj, se kjo ka pasur pikëpyetje për të shkuarën?”, tha Beqiri, duke shtuar se institucionet përgjegjëse duhej t’ia përcillnin informacionin personave që merrnin vendimin për emërimin.

Hyseni u propozua nga kryeministri Edi Rama për drejtimin e SHISH-it në mars 2023 dhe u dekretua nga presidenti Bajram Begaj më 3 prill të po atij viti. Në atë kohë, Rama e justifikoi propozimin duke iu referuar përgatitjes, përvojës dhe reputacionit të saj në komunitetin ndërkombëtar të inteligjencës.

Duke folur për zinxhirin institucional të emërimit, Beqiri tha se përgjegjësia nuk duhet parë vetëm te personi që ka mbajtur detyrën.

Sipas tij, përgjegjësi kanë si ai që bëri propozimin, ashtu edhe ai që e dekretoi.

“Patjetër që Presidenti, që të dy kanë përgjegjësi. (...) Pavarësisht se kush ia rekomandon, ai e ka bërë propozimin se ia jep Kushtetuta, që të bëjë propozimin dhe dekretohet nga Presidenti i Republikës. Të dy kanë përgjegjësi”, u shpreh ish-drejtuasi i SHISH-it.

Komentet e Beqirit vijnë në një moment kur Vlora Hyseni është nën hetim nga SPAK dhe ndaj saj është caktuar masa “arrest në shtëpi”, në kuadër të procedimit penal nr. 20/1 të vitit 2025. Sipas SPAK, ajo hetohet për “përkrahje të autorit të krimit” dhe “zbulim të akteve ose të dhënave sekrete”.

Megjithatë, këto janë akuza në kuadër të një hetimi dhe nuk përbëjnë një vendim përfundimtar mbi fajësinë e saj.

Në këtë kontekst, deklaratat e Beqirit e zhvendosin debatin nga vetë hetimi te mënyra se si u përzgjedh dhe u verifikua një person që iu besua drejtimi i një prej institucioneve më sensitive të shtetit.

Etiketa: Evarist Beqiri shish VLORA HYSENAJ

Lajme të lidhura



Kur krimi mbërrin në majën e inteligjencës shqiptare

21:49 : 23/09/2026



Gazetarja: Ndërkombëtarët kërkuar ndërhyrjen e SPAK, aksesit i Agasit te SHISH ngriti pikëpyetje

21:42 : 23/09/2026



9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?

20:42 : 23/09/2026




Dosja e SHISH, Salianji: Shteti ka rënë në duart e bandave

19:55 : 23/09/2026



510 komunikime Hyseni-Agasi, Berisha: Pse ish-kreu i SHISH nuk u cilësua pjesë e grupit kriminal?

18:53 : 23/09/2026



E përfshirë në dosjen e Ergys Agasit/ Ish drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni nesër para GJKKO

16:48 : 23/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.